

## **Ankesat për mos zbatimin e kërkesave të njoftimit dhe konsultimit publik**

1. Ankesat për mos zbatimin e kërkesave të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, që për pasojë kanë penguar mundësinë e pjesëmarrjes së publikut dhe të të gjitha palëve të interesuara në procesin e njoftimit e të konsultimit publik, kur projektakti nuk është miratuar ende, përfshirë: a) publikimin në regjistrin elektronik të projektaktit, të njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve, b) publikimin në programin e transparencës të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, në kuptim të këtij ligji, c) dhënien e informacionit në lidhje me procesin e njoftimit dhe të konsultimit publik në të gjitha fazat; d) afatin për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve, e) njoftimin për takime publike, idrejtohen Kryetarit të Këshillit.
2. Kryetari ia përcjell ankesën Sekretarit për vlerësim dhe merr përgjigje nga Sekretari për shkaqet që kanë çuar në dërgimin e ankesës, veprimin apo mosveprimin e ndërmarrë nga Sekretari për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe masat e propozuara nga Sekretari për zgjidhjen e ankesës.
3. Kryetari vlerëson faktet e paraqitura në ankesë dhe sqarimet e Sekretari, si dhe merr masa të menjëhershme për korrigjimin dhe reflektimin e vërejtjeve të paraqitura në ankesë, nëse ato janë të drejta. Në çdo rast, Kryetari njofton ankuesin për masat e marra brenda afatit 10 ditë pune nga regjistrimi i ankesës pranë Bashkisë, dhe e fton të jape komentet dhe rekomandimet për projektaktin.
4. Ankuesi mund të ankohen pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të aktit.